



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9102/2024
Data: 18.11.2024

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e Dhjete -X- për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 30.11.2024 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete.

RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2 Takim me Zyrtarin e zyrës ligjore.
- 3.Takim me Drejtorinë për Buxhet dhe financa.
- 4.Takim me inspektoren e Sanitarisë.
- 5.Eventuale.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2 Takim me Zyrtarin e zyres Ligjore.

Kryesuesi thekson:- Zyrtari i zyres ligjore mungon , në muajin tjetër i dergojm ftesë perseri.

3.Takim me Drejtorine për Buxhet dhe financa

Kryesuesi thekson:- Si është gjendja financiare e komunës pasi që kam ndëgjuar që komunat kanë mungesë të buxhetit ?

Lindita Ballazhi thekson: Fillimisht ju kerkoj falje për mungesen e muajit të kaluar pasi kam qene duke pregaditur buxhetin e komunës per vitin 2025 , gjendja e buxhetit nuk është aq e mirë për shkak të kontratave kolektive por tek ne është me e theksuar sepse e kemi një buxhet shumë të limituar përmbaruesi ka prek çdo kategori buxhetore tek mallrat,sherbimet komunale, subvencionet si dhe te investimet kapitale deri në nentëmujo rreth 204.000€ janë ekzekutuar për kontraten kolektive që rrjedh nga sektori i arsimit për shujtat trasporti inflacion

Kryesuesi thekson: Qeveria thot që nuk kanë faj kush ka faj këtu komuna apo qeveria nuk ka ndar mjete të mjaftueshme

Lindita thekson: nuk ka faj as qeveria e as komuna sepse qeveria ka potencuar që nuk ka nënshkruar kontrata kolektive ndersa barra i mbetet komunës,

Kryesuesi thekson: A mbahen debate buxhetore a informohen qytetaret rreth gjendjes së buxhetit të komunës

Lindita Ballazhi thekson: po mbahet debate buxhetore mirpo kemi problem me pjesemarrjen e qytetareve.

Zaim Bela thekson:- A mundet përmbaruesi me nderhy edhe në paga dhe meditje të buxhetit të komunës

Lindita Ballazhi thekson: Komuna jone kemi bërë pajtime gjygsore me mesimdhensit për me i egzekutu qato kerkesa në permjet listes së pagave dhe i kemi percjell në thesar për egzekutim por thesari nuk i egzekojne dhe mesimdhensit gjejnë menyren tjetër me përmbarim përmbaruesi e qon lendën në thesar dhe thesari ku ke mjete aty merr tek pagat përmbaruesi ka marr rreth 115.000. €

Zaim Bela thekson: me të hyrat vetanake a mundet me i qit

Lindita Ballazhi thekson: Jo nuk mundet se gjithqka shkon me planifikim

Resul Suma thekson: Janë disa rrugë që po punohen si rr.Nehat Curri ekzodi 99 ,tek kufini në paldenicë a janë pagu këto a mundet me prek permbaruesi në këto projekte

Lindita Ballazhi : Nuk mundet të paguhen pa u bë pranimi teknik po përmbaruesi mundet me i prek

Resul Suma thekson: Edhe sa është borgji i shujtave

Lindita Ballazhi : Nuk kam informacion sepse kjo pyetje i drejtohet zyres ligjore .

4.Takim me inspektoren e Sanitarisë.

Kryesuesi theskon: Kalojmë në piken tjetër me rradhe pasi që nuk është prezent

4.Eventuale

Nuk pati diskutime

Mbledhja perfundoi në 14:45

Procesmbajtësja
Sara Berisha

